



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Kruje me 20.12.2024

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME

ME
OBJEKT

“MBIKQYRJA E PUNIMEVE PËR OBJEKTIN “SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGËS SË DOKËVE (LIQENIT), FSHATI VERJON, NJ.A.NIKËL, KRUJË”) PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

I mbajtur sot me date 20.12.2024 ne Kruje prane Zyres se Prokurimeve , nga ana e Njesise se Prokurimit i caktuar me urdherin nr.619 date 18.12.2024 te Titullarit te AK , me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit e llojit “E Hapur e Thjeshtuar” dhe ne referim te urdherit te **prokurimit nr.619 date 18.12.2024** , me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS “MBIKQYRJA E PUNIMEVE PËR OBJEKTIN NDËRTIM KUZ LAGJA PALOKA (ZGJATIM LINJE), FSHATI LUZ I POSHTËM, NJ.A.FUSHË KRUJË, KRUJË”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):Mbikqyrja e punës se ndertimit /(71521000-6)

VLERA E FONDIT LIMIT: 38’753 (tridhjetë e tete mije e shtateqind e pesedhjetë e tre) leke pa tvsh, vënë në dispozicion nga të Ardhurat e Bashkisë Krujë.

BURIMI I FINANCIMIT :Te ardhurat e Bashkise Kruje

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

(“MBIKQYRJA E PUNIMEVE PËR OBJEKTIN NDËRTIM KUZ LAGJA PALOKA (ZGJATIM LINJE), FSHATI LUZ I POSHTËM, NJ.A.FUSHË KRUIJË, KRUIJË”)

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (Ne vleren prej 2% te fondit limit te lotit respektiv)

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet te kete detyrime te taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe ato te vitit 2024 te njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘‘ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2024 per secilin operator)

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2024 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘‘ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se taksas vendore 2024 per secilin operator).

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 41, pika 5 nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

b) Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me licencë të vlefshme profesionale të shoqërisë dhe të drejtuesve teknikë, për Mbikqyrje dhe Kolaudim te Punimeve te Zbatimit , të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore (sipas modelit te miratuar nga MZHU/MTI/MIE) me kategoritë e mëposhtme:

-NP-1→Punime gjermimi në tokë.

-NP-7→Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.

-NS-18→Punime topogjeodezike.

Shenim –Licensa duhet te jete leshuar sipas rregullave te VKM nr.759 date 12.11.2014 ‘‘Per licencimin profesional te individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’’ (Ndryshuar me VKM nr.943, datë 28.12.2016)

- *Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ‘‘Për prokurimin publik’’, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ‘‘Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’’, si dhe VKM nr.759 date 12.11.2014 ‘‘Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim’’ i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Kategorite e kerkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve qe do realizohen sipas preventivit dhe projektit te zbatimit.

Kerkesa e disponimit te nje license te tille te leshuar nga ana e organeve kompetente eshte e lidhur ngushtesisht me tipologjin e sherbimit te kerkuar objekt kontrate si dhe elementeve te zerave te preventivit , ku jane zera te cilet jane te pasqyruar ne VKM nr 629 date 15.07.2015 ‘‘Per Miratimin e Manualeve Teknike te Cmimeve te Ndertimit dhe analizat teknike te tyre’’

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’’.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.a-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2021’2022’2023) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te **kontrates/ lotit (për secilin prej loteve/ shumatores së loteve për të cilat konkurron)**.

Shenim-Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ‘‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’’ si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘‘Për tatimin mbi të ardhurat’’, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 ‘‘Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike’’, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, ‘‘Për tatimin mbi të ardhurat’’, i ndryshuar,

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar nën 77 të LPP, si edhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 5 dhe 6, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në vlerën e marre reference për kufirin e raportit të % se kufirit të xhiros për të konsideruar të plotësuar kriterin e mesipër, argumentojmë se ky raport që përben kufirin maksimal të përcaktuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i atribuohet faktit se duke marrë në analizë vlerën e fondit limit është me se e mundur që ky kufi iu jep mundësi të gjithë subjekteve ekonomike të çdo lloji kapaciteti financiar (të mesëm dhe të vegjël), të kenë mundësinë e ofertimit pasi është marzhi tejet i aksesueshëm

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1-Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës **me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit (për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron)**, që prokurohet .

Për të vërtetuar këtë Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin:

- Kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme, është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kontratës si dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumatat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruara nga të dyja palët.
- Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumatat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të

këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4-a) Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertës së tyre ekonomike/financiare duhet ti referohen VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, me Nr. 5585 Prot “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016” “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” si dhe Rekomandimit të datës 27.06.2018 me nr 6559 prot te APP.

b) Shenim- Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

- Fondi limit i preventivit të zbatimit të objektit, **Ndërtim KUZ Lagja Paloka (Zgjatim Linje), fshati Luz i Poshtëm, Nj.A.Fushë Krujë, Krujë**, është 1’614’703 (një milion e gjashtëqind e katërmbedhjetë mijë e shtatëqind e tre) lekë pa t.v.sh
- Reference për përlogaritjen e tarifës (fondit limit) për vlerën e mbikëqyrjes /kolaudim është përdorur **Grupi Tarifor III sipas** tabelës përkatëse V.K.M nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në njoftimin Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, dhe **VKM nr.610 date 22.09.2022** “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike/termave të referencës

- Termat e References per proceduren respektive jane hartuar nga Drejtoria e Planifikimit te Territorit te Bashkise Kruje sipas te dhenave te shkreses me nr. ____ Prot datë __. __. 2024 .Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit , konkretisht Ligjit nr.107/2014 ‘Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit’, normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e Ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar,udhezimit nr 3 date 15.02.2001 i KM ‘Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te zbatimit ne ndertim’’ i ndryshuar
- Termat e References per sherbimin e mbikqyrjes , jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.
- **Fondi Limit i perllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te V.K.M nr.354 date 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.**, dhe jane marre ne konsiderate te tere elementet perberes te sherbimeve te domosdoshme per ekzekutimin e kontrates.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK

EGLANTINA SUBASHI

MELISA KUPA

MIKEDA CACA